



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KRYETARI

Nr. 1201 prot.

Korçë, më 06.02.2025

URDHËR I BRENDSHËM  
Nr. 113 Datë 06.02.2025

PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN E SJELLJES SË  
NËPUNËSVE CIVILË GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu 2, neni 5 dhe neni 37, ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, dhe vendimit nr. 90/2012 të KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”

**KONSTATOJ:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka udhëzuar njësitë përgjegjëse për të ngritur grupin e monitorimit, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe vijueshmërinë normale të punës, së trupës së nëpunësve civilë, të pa ndikuar nga procesi zgjedhor, gjatë veprimtarisë së tyre.

Në këto rrethana, mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:
  - **Znj. Anxhela Qeramixhi (Dishnica)**, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore **Kryetar**
  - **Znj. Maria Baki**, Specialist Juriste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse **Anëtar**
  - **Znj. Dorina Jaup**, Specialist për Burimet Njerëzore dhe Performancën **Anëtar**
2. Koordinatorin e grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të jetë znj. **Maria Baki** me detyrë Specialist Juriste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

3. Grupi i punës të hartojë deri në datën 15.02.2025 rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregullime specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën do ta paraqesë për miratim tek titullari i institucionit.
4. Me këtë Urdhër dhe Rregulloren e Brendshme të grupit të punës, të njihen të gjithë nëpunësit civilë dhe të informohet Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, brenda datës 20.02.2025, duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës.
5. Me zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Grupi i punës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse .
6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Sotiraq Filo**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
GRUPI I MONITORIMIT

Nr. 1201/1 prot.

Korçë, më 06.02.2025

Miratoi:  
KRYETARI I BASHKISË  
Sotiraq Filo



**RREGULLORE E BRENDSHME E GRUPIT TË MONITORIMIT, NË LIDHJE ME  
MBIKQYRJEN E SJELLJES SË NËPUNËSIT CIVIL GJATË PERIUDHËS SË  
FUSHATËS ELEKTORALE PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME 2025**

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (Kreu 2, nenit 5 dhe nenit 37 të ligjit në fjalë), ligji nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë, nr. 113, datë 06.02.2025 "Për ngritjen e Grupit të Monitorimit"

- ✓ me qëllim që të vendoset kontrolli mbi sjelljen e nëpunësve civilë në përputhje me ligjin, në këtë situatë specifike. në kushtet e zgjedhjeve qendrore
- ✓ për të siguruar parimin e paanësisë politike, mbi të cilin bazohet administrimi i shërbimit civil (neni 5, Kreu II, i ligjit në fjalë) ;
- ✓ për të siguruar zbatimin e ligjit, në drejtim të respektimit të të drejtave politike të nëpunësit civil, e njëkohësisht edhe të kufizimeve të vendosura në dispozitën që përfaqësohet nga neni 37, i ligjit në fjalë, ku ndër të tjera, ndalohej pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike;
- ✓ si dhe për të siguruar vijueshmërinë normale dhe të pa ndikuar nga fushata zgjedhore, te veprimtarisë së trupës së nëpunësve civilë, në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, në këtë institucion,

**Grupi i Monitorimit**, harton këtë Rregullore të Brendshme e cila përcakton objektin e veprimtarisë së tij, si dhe vendosjen e disa rregullave të hollësishme të cilat duhet të ndiqen nga nëpunësit civilë, gjatë periudhës së fushatës elektorale, të cilat do të jenë edhe objekt i kontrollit të grupit *ad-hoc*, të ngritur në këtë rast.

**Objekti i veprimtarisë** së këtij grupi do të jetë sjellja e nëpunësve civilë gjatë fushatës elektorale, që ka të bëjë me realizimin e detyrave të tyre funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe me zbatimin e disiplinës formale në punë.

Grupi i Monitorimit do të veprojë në bashkëpunim të ngushtë me eprorët direkt të nëpunësve civilë, si dhe me njësinë e administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të respektojë diskrecionin ligjor të këtyre subjekteve, në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj.

**Puna për realizimin me sukses të objektivit të këtij grupi do të përqendrohet në këto aspekte të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë nëpunësit civilë të institucionit:**

1. Në një regjistër të posaçëm, i cili do të administrohet nga Grupi i Monitorimit, nëpunësit civilë duhet të shënojnë çdo ditë hyrje - daljet në institucion, destinacionin, si dhe eprorin që e ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës, duke filluar nga ora 08.00 -16.30 nga e hëna në të enjten dhe nga ora 08.00 -14.00 çdo të premte.
  2. Nga ana e Njesisë së Administrimit të Burimeve Njerëzore, duhet të shënohen në orën 8.00, të gjithë nëpunësit civilë që janë me shërbim jashtë institucionit, destinacioni si dhe akti administrativ me të cilin është autorizuar lëvizja.
  3. Në fund të çdo dite pune, deri në përfundim të fushatës elektorale, listë prezenca e nëpunësve civilë do të nënshkruhet nga Grupi i Monitorimit dhe do të bëhet pjesë e dokumentacionit që do të materializojë veprimtarinë e tij.
  4. Nëpunësit duhet të jenë në çdo moment të gatshëm për t'u përgjigjur në telefon, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e vendndodhjes së tyre, gjatë sondazheve të realizuara nga Grupi i Monitorimit. Për këtë arsye, ata duhet të regjistrojnë numrat e telefonit, pranë njesisë së administrimit të burimeve njerëzore.
  5. Eprorët direkt, duhet të jenë në çdo rast në dijeni të lëvizjes së stafit të tyre, në të kundërt, mos pasja dijeni për mungesa të stafit, do të konsiderohet si mospërbushje e detyrave funksionale nga ana e tyre.
  6. Gjatë orarit zyrtar 08.00 -16.30 nga e hëna në të enjten dhe 08.00 -14.00 çdo të premte, nëpunësit civilë nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të ndonjë natyre tjetër, për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.
- Nëpunësi civil nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit, me kolegët apo qytetarët/ të mos përdorë apo mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e institucionit/të mos lejojë përdorimin apo mbajtjen e posterave, fletëpalosjeve dhe të simboleve të subjekteve politike, nga qytetarët që marrin shërbime në ambientet e institucionit. Po kështu, nëpunësi civil nuk duhet të shprehë hapur bindjet e tij politike në rrjetet sociale, platformat sociale apo mediat *on line*, si dhe në çdo lloj komunikimi tjetër elektronik, që shfaqet në publik.
- Nëpunësi civil, të informojë grupin e monitorimit, në rastet kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje

7. Pas orarit zyrtar, nëpunësi civil, nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.

8. Grupi i Monitorimit do të organizojë kontrole në frekuenca të shpeshta gjatë orarit zyrtar, të cilat do të materializohen në procesverbale, ku nëpunësit prezent në punë, duhet të nënshkruajnë në mënyrë individuale në këto akte, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.

9. Grupi i Monitorimit, nëpërmjet koordinatorit të emëruar nga ky grup, do të komunikojë çdo ditë me personin e kontaktit, pjesë e Grupit të Gatshëm, të ngritur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe do të përcjellë në kohë reale orientimet e këtij institucioni, me qëllim që të monitorohet sa më objektivisht situata dhe të zgjidhen në kohë problemet që dalin gjatë procesit të monitorimit.

10. Grupi i Monitorimit do të ndjekë me vëmendje transmetimet në media, me qëllim që të evidentojë çdo rast të sjelljes së nëpunësit civil në kundërshtim me ligjin.

11. Të gjitha rastet e konstatuara me shkelje, Grupi i Monitorimit do ti dërgojë për fillimin e ecurisë disiplinore, pranë eprorit direkt, ose pranë Komisionit të Disiplinës, sipas rëndësisë së shkeljes së kryer, apo denoncim në prokurori nëse është rasti.

Dispozitat e kësaj rregulloreje, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga grupi i monitorimit si dhe nga nëpunësit civilë të institucionit, të cilët duhet të njihen me këtë rregullore, nëpërmjet njësisë së administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të mundësohet zbatimi i rregullave të vendosura në të, nga ana e tyre.

Rregullorja hyn në fuqi në ditën e miratimit nga titullari i institucionit dhe është e vlefshme për periudhën zgjedhore në zgjedhjet qendrore, 2025.

Veprimi në kundërshtim me rregulloren, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit civil.

### GRUPI I MONITORIMIT

1. **Znj. Anxhela Qeramixhi (Dishnica)**, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore  
Kryetar
2. **Znj. Maria Baki**, Specialist Juriste në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll-Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse  
Anëtar
3. **Znj. Dorina Jaup**, Specialiste për Burimet Njerëzore dhe Performancën  
Anëtar